

# ACTELLIC 50 EC

## PRODUKT PER MBROJTJEN E BIMEVE



RREZIK

- Lëngu dhe avujt të ndezshëm.
- I dëmshëm nëse gëlltitet.
- Mund të jetë fatale nëse gëlltitet dhe thithet me organët e frymëmarrjes.
- Mund të shkaktojë reaksion alergjik të lëkurës. Përmban pirimiphos-methyl.
- Shkakton dëmtim serioz të syve.
- Mund të shkaktojë acarim të rrugëve të frymëmarrjes.
- Mund të shkaktojë përgjumje ose marrje mendsh.
- Dysohet se shkakton kancer.
- Shkakton dëmtime të organeve (sistemi nervor qendror).
- Shkakton dëmtime të organeve (sistemi nervor) pas ekspozimit të zgjatur ose të përsëritur.
- Shumë toksik për organizmat ujorë, me efekte afatgjata.

ACTELLIC 50 EC është insekticid fosforoorganik që vepron nëpërmjet kontaktit, aparatit tretës dhe avujve. Ai vepron në sistemin nervor të insekteve dhe marimangave si frenues i acetilkolinesterazës.

### GRUPI 1B INSEKTICID

**Lenda vepruese:** *Pirimiphos methyl 500 gr/l.*  
**Formulimi:** *Koncentrat i emulsionueshem (EC)*

#### Masat parambrojtëse:

- Lexoni udhëzimet speciale përpara përdorimit.
- Mbajeni larg të nxehtit/shkëndijave/flakëve të hapura/sipërfaqeve të nxehta. Ndalohet duhani.
- Mbajeni freskët.
- Mos thithni pluhurin/tymin/gazin/mjegullën/avujt/spërkatjen.
- Lani duart me kujdes pas trajtimit.
- Mos hani e mos pini lëngje ose duhan gjatë përdorimit.
- Përdoreni vetëm jashtë ose në vende të ventiluara mirë.
- Rrobat e ndotura/kontaminuara nuk duhet të lejohen jashtë vendit të punës.
- Shmagni shkarkimet, derdhjet në mjedis.
- Vishni dorashka mbrojtëse/rroba mbrojtëse/mbrojtëse për fytyrën/sytë.
- Vishni kominoshe të përshtatshme, dorashka dhe pajisje mbrojtëse personale për fytyrën dhe sytë kur përdorni formulimin dhe pajisjet e trajtimit.
- Këshillohet mbajtja e dorashkave dhe maskave të përshtatshme kur punohet me farat e trajtuara.
- Trajtimi lejohet vetëm duke përdorur pajisje të automatizuara dhe jo manuale.
- Hidhjeni përmbajtjen/kontejnerin në përputhje me legjislacionin kombëtar.

#### Udhezime per ndihmen e pare dhe keshilla per mjekun:

- Në përgjithësi: Në rast aksidenti ose nëse nuk ndjeheni mirë, kërkoni menjëherë këshillë mjekësore (tregoni etiketën ose MSDS kur është e mundur). Në rast ekspozimi ose ka gjasa ekspozimi: Telefononi QENDRËN E HELMIMEVE. Konsultohuni / Vizitoni një mjek.
- Në rast gëlltije: Thirrni menjëherë Qendrën e Helmimeve ose mjekun nëse nuk ndiheni mirë. Mos provokoni të vjella.
- Në rast se merret me organet e frymëmarrjes: Nxireni të aksidentuarin në ajër të pastër dhe lëreni të pushojnë në një pozicion që lehtëson frymëmarrjen. Nëse ai nuk po merr frymë normalisht ose fare, aplikoni frymëmarrje artificiale. Mbajeni të ngrohtë dhe të shtrirë. Thirrni menjëherë Qendrën e

Helmimeve ose mjekun nëse nuk ndihet mirë.

- Në rast kontakti me sytë: Shpëljani menjëherë me ujë të bollshëm për disa minuta. Nëse ka lente kontakti, i hiqni ato po qe se është e lehtë. Vazhdoni shpërlarjen. Thirrni menjëherë Qendrën e Helmimeve ose mjekun.
- Në rast kontakti me lëkurën (ose me flokët): Hiqni menjëherë të gjitha rrobat e ndotura dhe lani ato para se ti ripërdorni. Shpëlani lëkurën me ujë /dush. Nëse shfaqet acarim ose skuqje e lëkurës: Këshillohuni / Vizitoni me një mjek.
- Në rast zjarri: Përdorni rërë të thatë, shkumë kimike të thatë ose rezistente ndaj alkoolit për ta shuar.
- Kërkohet trajtim i veçantë: ANTIDOTI: Atropina – oximes – toxogonin – sulfat atropine.

Tel. Urgjence: +44 1484 538 444.

### **Perdorimi:**

Lejohet për përdorime si insekticid vetëm për ruajtjen pas vjeljes.

**ACTELLI 50 EC** vepron kundër një grupi shume të gjere të insekteve demtues.

Mund të perdoret:

- *Ne mjedise të ndryshme si: depo, hambare anijesh, vagona trenash, etj.*, kundër tenjave, kalandrave, brumbujve, kepushave, miellngrenesve etj.

- *Per dizinfektimin e mjediseve boshe:*

*Me sperkatje:* - Perdoren 500 ml preparat në 15-100 litra uje, për 500 m<sup>2</sup>. Perdoren volume të medha në rastin e siperfaqeve me aftesi thithese të madhe. Synohet lagje e mire e siperfaqes, por pa filluar të rrjedhi.

*Me tymosje:* - Perdoren 25 ml preparat në 475 ml vaj të bardhe ose tretes kerosone, për të trajtuar 500 m<sup>2</sup>.

- *Per dizinfektimin e produkteve:*

*Kur produktet (grure, miser, oriz, bishtajore, fara të ndryshme, miell etj.) janë në thase*, perdoren 50-100 ml ACTELLIC 50 EC në 5 litra uje për 100 m<sup>2</sup> siperfaqe thesi. Sperkatet dyshemeja dhe siperfaqja e jashtme e çdo thesi pastaj stivosen. Për efekt me të zgjatur tretën 200 ml preparat në 10 litra uje dhe perdoren 50 ml tretesire sperkatese për m<sup>2</sup>.

*Kur prodhimi është i derdhur (rifuxho):* - tretën 8-20 ml preparat në 1-2 litra uje për çdo 10 kv prodhim, duke sperkatur në shtresa çdo 50 cm.

### **Verejtje për perdorimin:**

Mos sperkatni enet dhe siperfaqet në të cilat pergatiten ushqime. Ajrosni ambientet e tymosura përpara se të rifuteni brenda. Aplikimet me pompat e dorës nuk lejohen.

Për përdorime të ndryshme nga aplikimet me sisteme të automatizuara në depot bosh të drithërave, do t'i kushtohet vëmendje e veçantë kriterëve dhe do të sigurohet çdo e dhënë dhe informacion i nevojshëm.

Në vlerësimin e përgjithshëm, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë:

- sigurisë së operatorëve. Kushtet e autorizuar të përdorimit duhet të përshkruajnë aplikimin e pajisjeve adekuate mbrojtëse personale duke përfshirë pajisjet mbrojtëse të frymëmarrjes dhe masat për zbutjen e rrezikut për të reduktuar ekspozimin;

- ekspozimit dietik të konsumatorëve në funksion të rishikimeve të ardhshme të niveleve maksimale të mbetjeve.

### **Fitotoksiciteti:**

ACTELLIC 50 EC nuk është fitotoksik në dozat e rekomanduara.

### **Ndikimi në ekosistem:**

Shumë toksik për organizmat ujorë, me efekte afatgjata. Mos ndotni ujrën me preparatin ose ambalazhin e tij.

### **Karenca:**

Hyrja e njerëzve në zonën ku është bërë trajtimi lejohet vetëm me përdorimin e pajisjeve mbrojtëse 24 orë pas aplikimit dhe vetëm nëse hapësira është ajrosur mirë për të paktën 1 orë.

### **Magazinimi:**

Ruhet në vende të mbrojtura nga dielli dhe lagështia, në ambalazhin origjinal, në temperature -10 deri 35 °C.

Nr dhe data e regjistrimit: 5/2; date 14.11.2008.

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin baze: 50 ml, 100 ml, 1 lit, 200 lit.

Data e prodhimit .....

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkeseva të përcaktuara): 2 vjet;

Numri i partise se mallit (serise) ose shenja te tjera identifikuese .....

Tipi i ambalazhit baze: shishe HDPE (High density polyethylene).

Emri dhe adresa e kerkuesit: 2022 Environmental Science FR SAS. **Adresa:** 1 place Giovanni Da Verrazzano, 69009 Lyon, France.

Emri dhe adresa e fabrikuesit te PMB-se: Syngenta Crop Protection AG. **Adresa:** Basel, Switzerland.

Emri dhe adresa e ambalazhuesit (kur ambalazhimi kryhet ne Republikën e Shqiperise): .....